



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë B e folur dhe e shkruar (1+2)

Ngarkesa: 4 kreditë, 40 seminare
Viti / Semestri: Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në ‘‘Përkthim dhe Interpretim në gjuhë ruse ‘‘
Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektiva të përgjithshme: Ky kurs do t’u mësojë studentëve elementin leksikor dhe shprehitë e të folurit dhe të shkruarit. Të formojë tek ata shprehitë kryesore të domosdoshme për të vazhduar më tej studimin e lëndëve të tjera; Të zgjerojë dhe të pasurojë tek ata shprehitë për përshkrimin e botës që na rrethon; Të edukojë tek ata aftësinë për të dalluar, krahasuar, përgjithësuar, konkretizuar dhe për të nxjerrë konkluzione që nxisin zhvillimin e analizës analitiko-sintetike, të menduarit saktë; Të pasurojë fjalorin e studentit me fjalë, shprehje e konstrukte të reja.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të emërtojë dhe karakterizojë objektet dhe dukuritë e ndryshme, t’i krahasojë dhe t’i diferencojë ato;
2. Të marrë pjesë lirshëm në bisedë;
3. Të shprehet lidhur me një temë të caktuar, bazuar mbi konstatime të vetat dhe të mund të ndërtojë një tregim logjik;
4. Nëpërmjet ushtrimeve dhe dialogjeve dhe teksteve të ndryshme të përvetësojë shprehitë e marra dhe të mund të ndërtojë vetë një tekst bazuar mbi to.

Rezultate të pritshme:

1. Në përfundim të kursit, studenti pritet të jetë në gjendje të:
2. Kuptojë dhe përdorë fjalorin elementar të gjuhës ruse në situata të thjeshta komunikimi të përditshëm (prezantim, përshëndetje, pyetje dhe përgjigje të zakonshme).
3. Formulojë fjali të thjeshta në mënyrë të saktë gramatikore, duke respektuar strukturat bazë sintaksore të gjuhës ruse.
4. Lexojë dhe kuptojë tekste të shkurtra me përmbajtje të thjeshtë në gjuhën ruse, duke nxjerrë informacionin kryesor.
5. Kuptojë mesazhe të thjeshta të dëgjua në një ritëm normal komunikimi, si udhëzime, përshkrime.